



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____ . _____ . 2023

VENDIM

Nr. 528, datë 11.10.2023

PËR

**TRANSFERIMIN E PËRKOHSHËM TË GJYQTARIT
Z. {...} NË GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM TIRANË**

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetur në nenin 46 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në vendimin nr. 23, datë 07.02.2019 të KLGJ-së “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit” i ndryshuar, në vendimin Nr. 511 datë 05.10.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe duke mbajtur në konsideratë dhënien e pëlqimit të gjyqtarit {...} me shkresën nr. 5159 prot., datë 06.10.2023, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

VENDOSI:

1. Transferimin e përkohshëm me pëlqim të gjyqtarit z. {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një periudhë deri në një vit, që mund të ndërpritet në rast të ndryshimit të rrethanave që kushtëzuan transferimin.
2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 16.10.2023.
3. Gjyqtari z. {...} përjashtohet menjëherë nga procedurat e ndarjes së çështjeve gjyqësore në gjykatën ku ka caktimin e përhershëm, Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë.
4. Gjyqtari z. {...} ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet gjyqësore që ka në gjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, që ndodhen në fazën e konkluzioneve përfundimtare, si dhe gjykimin e çështjeve të veçanta, në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme, të caktuara me vendim të Këshillit. Çështjet e tjera gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm së Parë Gjirokastrë dorëzohen menjëherë prej tij.
5. Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

6. Një kopje e vendimit i njoftohet z. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë.

Ky vendim hyn në fuqi me botimin në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR